

Servizio politiche della pace, solidarietà e associazionismo
Struttura stabile per gli immigrati

ITALISHT/SHQIP




BOTIMI I 2^{te} I AZHORNUAR

MBI TE DREJTAT

UDHEZUES PER ORIENTIM

Te huajt, te huajat
dhe puna e pasigurt

Servizio politiche della pace, solidarietà e associazionismo
Struttura stabile per gli immigrati



Gli stranieri, le straniere e il lavoro precario

GUIDA PER L'ORIENTAMENTO AI DIRITTI

2^a EDIZIONE AGGIORNATA



ITALIANO/ALBANESE

Unione Italiana degli Immigrati del Friuli Venezia Giulia

Via Ugo Polonio, 5 - 34125 Trieste

tel +39 040 367800 - fax +39 040 367803

e-mail: immigrati@uilfvjg.it - codice fiscale 90085500321

Finito di stampare nel mese di marzo 2008
presso la Tipografia Pellegrini-Il Cerchio, Udine

Unione Italiana degli Immigrati del Friuli Venezia Giulia

Via Ugo Polonio, 5 - 34125 Trieste

tel +39 040 367800 - fax +39 040 367803

e-mail: immigrati@uilfvjg.it - codice fiscale 90085500321

Finito di stampare nel mese di marzo 2008
presso la Tipografia Pellegrini-Il Cerchio, Udine

**TE HUAJT E TE HUAJAT
DHE PUNA E PASIGURT:
UDHEZUES PER ORIENTIM MBI TE DREJTAT**

Botimi i 2te i azhornuar

ITALISHT/SHQIP

Tregues

Shenim hyrje mbi botimin e dyte	3
Parathenie	4
Disiplinimi i punes per te huajt/ajat ne Itali	7

Pune e pasigurt nen varesi

1. Kontrata e punes me sherbime te pavazhdueshme	9
2. Kontrata e punes se pjesetuar ose job-sharing	11
3. Kontrata e punes ne dhenie	12
4. Kontratat e mesimit te profesionit	13
5. Kontrata e hyrjes ne pune	14

Pune e pasigurt e pavarur e parasubordinuar

6. Kontrata per shoqerim ne pjesemarrje me kryerje pune	15
7. Kontrata e bashkepunimit me projekt te caktuar	17

Pune e pasigurt e pavarur rastesore

8. Kontrata e bashkepunimit rastesor	19
9. Kontrata e sherbimeve te punes ndihmese ose kupone pune	20

Shkurtime dhe sigla

Ne tekst jane perdorur shkurtime dhe siglat e meposhtme:

v.e.h./v.h. = viza e hyrjes/vize hyrje;

l.e.q./l.q.= leja e qendrimit/leje qendrimi;

ShShK = Sherbimi i Shendetit Kombetar;

KKKP = Kontrata Kolektive Kombetare e Punes.

Tekste te hartuara nga Michele Berti (Un.It.I. Friuli Venezia Giulia)

Perktheu Armanda Bejko

Falenderime

Un.It.I. Friuli Venezia Giulia falenderon personelin e Zyres se Imigrimit te Kuestures ne Trieste dhe ate te Sportelit te Punes te Provinces se Triestes per sugjerimet e vlefshme si dhe udhezimet e dhena per realizimin e botimit te dyte.

Tekste te azhornuara me date 25 shkurt 2008

Shenim hyrje mbi botimin e dyte

Ndryshimet e kryera ne lenden e politikës se punës nga Qeveria nepermjet aprovimit nga Parlamenti te ligjit 24 dhjetor 2007, n.247 i titulluar *“Norma te zbatimit te Protokollit 23 korrik 2007 mbi sigurimet shoqerore, pune e konkurrence per te favorizuar drejtesine dhe rritjen e durueshme, si dhe norma te tjera ne lenden e punës dhe te sigurimeve shoqerore”* na keshilluan te hartonim nje botim te dyte te azhornuar te ketij udhezuesi me qellim per te ofruar informacione e udhezime te vlefshme mbi te rejat e inisiuara me kuptimplote; nder te tjerat kujtojme eliminimin e kontrates se punës me nderprerje ose me thirrje. Un.It.I ne Friuli Venezia Giulia do kishte deshruar te realizonte nje azhornim akoma me te gjere, mbi te gjitha ne shfaqje te projektligjit *“Amato-Ferrero”* i cili i delegonte Qeverise e modifikimin e ligjit te ashtu-quajtur *“Bossi-Fini”*, duke sjelle te reja te rendesishme ne legjislacionin mbi imigrimin, edhe persa i perket disiplinimit te punës te te huajve/ajave. Por fundi i paraardhur i legjislatures XV te Parlamentit shtyn domosdoshmerisht ne te ardhmen aprovimin e mundshem te kesaj reforme.

Megjithate, mendojme se botimi i pare i ketij udhezuesi ka arritur rezultate te rendesishme: ai eshte pelqyer nga te huajt/ajat qe ndodhen ne Friuli Venezia Giulia dhe ka sherbyer si instrument orientimi ne lenden e punës, me perkthim ne gjuhete me te perhapura ne komunitetet kombetare prezente ne krahinen tone. Ky udhezues, gjithashtu ka dhene kontributin e tij ne nenvizimin e nje kunderthenie kuptimplote qe ekziston ne sistemin juridik italian: ate kunderthenie domethene te nje sistemi qe u kushton nje kujdes te drejte e gjithmone me te madh dallimeve, duke i kuptuar ato si fenomen per ti eliminuar, por i cili faktikisht i perjashteson te huajt/ajat (thjeshte nga kondita e tyre se qeni jo qytetare te Vendeve te Bashkimit Europian) nga mundesia per te perdorur disa kontrata pune, te inisiuar per tiu pergjigjur nevojave te ndryshueshme te tregut te punës italian.

Nenvizimi i kesaj kontradikte – pa dyshim jo e vetmja ne legjislacionin e imigrimit – i cili, e lehte te imagjinohet, ka nevojete per kohe te gjate para se te ndreqet, ben te qarte sa duhet punuar me tej mbi politikaten kunder dallimeve.

Ndoshta pikerisht nga kjo vetedije do kete rast te rrjedhe nje botim eventual i trete i ketij udhezuesi, ku te tregohet nje kapercim pozitiv.

Keshilli Drejtues
Un.It.I Friuli Venezia Giulia

Parathenie

Sasia e gjere e formave kontraktuale qe ekzistojne ne tregun e punes italian - shume nga te cilat jane krijuar nga i ashtu-quajturi ligji “Biagi” (D.Pune 10 shtator 2003, n. 276 dhe ndryshimet e plotesimet e pasardhura) – rrezikon te sjelle pasoja negative mbi jeten e te huajve/ajave qe qendrojne ose deshirojne te qendrojne ne Vendin tone. Keto kontrata te shumellojshme, ne fakt, nese nga nje ane mundesojne punedhenesin te kurseje mbi kushtet e punesimit, kane si rrjedhoje nje “pasiguri” (paqartesi) te dukshme te konditave jetike te punemarresve, ne lidhje normalisht me llojin e kontrates. Gjithashtu, nese konsiderohet qe keto forma pune - “jo komode” pikerisht sepse sjellese pasigurie – refuzohen sa me shume nga punemarresit italiane, eshte e mundur qe keto lloje kontratash tu ofrohen me me teper thjeshtesi te huajve/ajave.

Por, nese per nje italian te punesuar me keto lloje kontratash “te pasigurta” rreziku perkthehet ne uljen e te ardhurave dhe mbrojtjeve e sigurimeve shoqerore (welfare), per nje te huaj ne te njejtat kondita rreziku eshte me i larte, pasi, qe ne fillim, mund te kompromentohet ose te ndalohet plani i tij emigrues ne Itali, duke krijuar pasoja personale te renda nga pikepamja ekonomike dhe shoqerore.

Ligji italian mbi te huajt/ajat, i ashtu-quajturi “Bossi-Fini” (D.Pune 25 korrik 1998 n. 286, i ndryshuar nga l. 30 korrik 2002 n. 189 dhe integrimi te mevoneshme) rregullon, e domethene lejon, punen nen varesi (mund te jete edhe stinore) sikurse punen e pavarur. Megjithate, per te mundesuar mirepritjen e kerkesave per hyrje dhe qendrim ne Itali per arsye pune nen varesi, ligji i kerkon te huajit/ajes te tregoje te ardhura te barabarta ose me te larta sesa shuma e ndihmes sociale vjetore (normalisht e garantuar kundrejt nje angazhimi me te pakten 20 ore ne jave), sipas shperblimeve minimaleve te cdo KKKP). Madje, ne rast te disa kerkesave per hyrje dhe qendrim per arsye pune te pavarur, te ardhurat qe i huaji/aja duhet te tregoje nuk mund te jene me te uleta sesa ato qe mundesojne perjashtimin nga pjesemarrja ne shpenzimet shendetesore. Pasojat jane kontratat e punes te “pasigurta” qe nuk synojne te garantojne te ardhura minimale per punemarresin/en e te cilat mund te mos jene te mjaftueshme per nje te huaj, ne rast se perbejne burimin e te ardhurave te tija te vetem.

Ne fund, mundesia per te fituar njohjen e disa te drejtave themelore per njeriun (pra edhe te huajve), per shembull sigurimi shendetesor prane ShShK ose pajisja me shtepi ne kushte te barabarta me qytetaret italiane, nepermjet dhenie banesash shteterore, varet ne raste te shumta nga konditat e pajisjes me pune, nen varesi ose e pavarur, ashtu sic hartohet nga ligji mbi

te huajt/ajat. Nese te gjithë kesaj i shtohet fakti se – per arsye diferencash kulturore, gjuhësore, dhe veshtiresishe per tu drejtuar Enteve Publike te Vendit tone – te huajt/ajat shpeshhere nuk kane nje njohuri te gjere te ligjit qe rregullon hyrjen dhe qendrimin e tyre ne Itali, duket e qarte sesi per nje te huaj oferta e nje kontrate pune “e pasigurt” perben nje gjendje shume te rrezikshme. Kjo gjendje nuk eshte aspak e rralle.

Per te gjitha arsyet e shtruara me siper, ky udhezues – rrealizuar per te huajt/ajat qe jane punonjes/e ose qe duan te behen te tille – synon ti informoje ata, per ti ndihmuar te kalojne veshtiresine e njohjes se ligjit “Bossi-Fini” te cilet shume nga ta kane, me shpresen qe te jene me te vetedijeshem, te pergatitur dhe te gatshem per te perballuar fushen e punes, pa harruar detyrimet qe ligji u imponon. Megjithate, duhet theksuar se ky udhezues nuk perben nje studim te thelle te tipit tekniko-juridik mi te drejtat dhe detyrimet e personave qe fillojne pune. Me tej, ne nje fushe ku klasifikimet nuk arrijne te jene konkrete dhe koherente deri ne fund, ky udhezues perdor disa kriteret per te diferencuar tematikat, me deshiren qe te pajise lezuesit me ato mjete aq te vlefshme per tu orientuar dhe per te perballuar me lehte kete lende te nderlikuar. Tek analizon kontratat e punes te pasigurt me te rendesishme mbi tregun e punes italian dhe tek i dallon ato ne llojet qe bejne pjese tek tipet e punes nen varesi ose te subordinuar dhe llojet qe renditen tek kategorite e punes se pavarur te parasubordinuar e rastesore, ai i pershkruan shkurt dhe analizon mundesite per te huajt/ajat – **vetem ne baze te cdo forme te konsideruar** – per te:

- a. marre v.e.h. per arsye pune dhe l.e.q. te pare per arsye pune;
- b. shtyre l.e.q. per arsye pune;
- c. ndryshuar l.e.q. me shkak tjeter, ne format e lejuara nga ligji, per arsye pune;
- d. marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate;
- e. regjistruar ne ShShK;
- f. marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shtetore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane.

Ne mbyllje, disa keshilla. Se pari, eshte e rendesishme te theksohet se gjashte llojet e kerkesave te analizuara per cdo lloj kontrate pune te konsideruar nuk kane lidhje me v.e.h. apo l.e.q. te marra per arsye pune nen varesi stinore ose per arsye pune ne raste te vecanta, domethene ne ato raste qe pervecohen nga kuotat e parashikuara nga dekretet mbi flukset. Kjo ndodh pasi jane me sasi me te ulet por edhe pasi keto lloje v.h. dhe l.q. nuk u japin mundesi te huajve – pervec disa rastesh shume te rralla – per te patur plane emigrimi teorike aq te gjata sa jeta e tyre.

Pika e dyte qe duhet nenvizuar eshte fakti se lenda e punes te pasigurt ende nuk eshte rregulluar ne menyre te perpikte dhe te plote nga Ministria e Brendshme dhe e Solidaritetit Shoqeror, domethene ato qe me shume se cdo tjeter kane pergjegjesi te drejteperdrejte mbi politikat e imigrimit. Per kete arsye, pas publikimit te ketij udhezimi, mund te merren masa te rendesishme mbi normat ekzistuese, deri ne ndryshim te temave te hartuara ne kete tekst. Ftojme lezuesit, pra, te azhornohen nepermjet burimeve qe gjenden me thjeshte. Nder keto kujtojme adresen e faqes se internetit se UIL <http://www.uil.it>, ku mund te gjehet nje arkiv normash dhe ligjesh, i azhornuar here pas here. Gjithashtu, duhet konsideruar qe entet territoriale te Ministrise se Brendshme (Kuesturat, dhe tek ekzistojne, Sportelet per migruesit neper Prefektura – Zyra territoriale Shtetore) si dhe zyrat e Krahinave dhe te Provincave kompetente ne lendet e punes mund te mos japin te njejtat pergjigje persa i perket kerkesave mbi punen e pasigurt, lende ende e pakodifikuar ne menyre te plote.

Se fundi, duhet patur parasysh fakti se pamjaftuesheria e te ardhurave jo gjithmone konsiderohet nga gjyqetaret si pengese per njohjen e te drejtes te te huajve/ajave per te qendruar ne Itali. Vitet e kaluara, faktikisht, jane shpallur vendime gjyqesore te shumta mbi kerkesa te posacme, te cilat u kane imponuar shume Kuesturave leshimin ose renovimin e lejeve te qendrimit, per te cilet fillimisht kerkesat e meparshme ishin refuzuar, pikerisht per arsye te pamundshmerise se te huajve/ajave per te permbushur kushtin e te ardhurave minimale te parashikuar nga ligji.

Disiplinimi i punes per te huajt/ajat ne Itali

Ligji “Bossi-Fini” e dallon veprimtarine e punes te te huajve/ajave ne:

- a) pune *nen varesi* (edhe e tipit stinor) dhe
- b) pune *te pavarur*.

D.Punes n. 286 kupton me pune *nen varesi* veprimtarine e punemarresit/es te kryer me karakteristikat si me poshte:

- detyrimin e varesise organizatore, hierarkike dhe disiplinore drejt nje punedhenesi;
- venien ne dispozicion te energjive per pune, sipas menyres se kohes, se hapesires dhe te kryerjes se veprimtarise se punes ashtu si jane vendosur nga punedhenesi;
- perdorimin e mjeteve dhe veglave te dhena nga punedhenesi.

Ne Itali puna nen varesi organizohet pothuajse ne menyre te plote nepermjet kontratash pune te vlefshme per te gjithë subjektet e punesuar ne fushat e ndryshme te ekonomise (metal-mekanike, tekstile, bujqesore, te ndertimit, etj.); te ashtu-quajturit KKKP, te cilat parashikojne tre kushtet e pershkruara siper.

D.Punes n. 286 gjithashtu kupton me pune *te pavarur* te gjitha format e tjera qe nuk kryhen me karakteristikat e permendura e – mes tyre percakton si forma te afta vetem ato jo rastesore. Si rezultat, puna e pavarur permbledh:

- veprimtarine e sipermartjes (edhe ne rast ortakerie ose firme individuale);
- profesionin veprimtor te lire;
- kontratat e punes te parasubordinuar ose ato qe parashikojne sherbime qe risjellin tek kjo forme;
- llojet kontraktuale te punes rastesore.

Nje dallim tjetër po aq interesant per sferen e punes italiane percakton:

- a) punen e *qendrueshme* ose *te sigurt* dhe
- b) punen e *pasigurt*.

Me pune *te qendrueshme* ose *te sigurt* kuptohet puna e subordinuar ose nen varesi e cila u garanton punemarresve nje kohezgjatje te pacaktuar ose te paravendosur, por mjaft te gjate, te lidhjes se punes, si dhe te ardhura minimale. Forma me e shpeshte ne te cilen gjendet puna e qendrueshme ose e sigurt eshte, pikerisht kontrata e punes nen varesi, e cila mund te kete kohezgjatjete te pacaktuar ose te caktuar (ne kete rast zgjatja eshte e fiksuar) dhe me kohe pune te plote, *full-time* (orari i punes eshte ai i caktuar nga

KKKP), ose me kohe te pjesshme, *part-time* (orari i punes eshte me i shkurter se ai normal i caktuar nga KKKP).

Me pune *te pasigurt*, ne rastin e kundert, kuptohen ato kontrata pune nen varesi dhe te pavarur te parasubordinuara e rastesore, te cilat – ndryshe si ndodh tek te tjerat – nuk u garantojne punemarresve nje kohezgjatje aq te gjate pune e te ardhura minimale.

Objekt i ketij udhezimi jane kontratat dhe format e punes te pasigurt, qofte ato te punes nen varesi, qofte ato te punes te pavarur, te parasubordinuar e rastesore.

1. Kontrata e punes me sherbime te pavazhdueshme

Puna me sherbime te pavazhdueshme eshte nje kontrate pune nen varesi e vecante, parashikuar ekskluzivisht per sektoret e turizmit dhe te spektaklit, ne te cilen punedhenesi therret punemarresin/en per pune vetem ne periudha te caktuara, per shembull ne qofte se lind ngarkese pune e madhe dhe punedhenesi ka nevojte perkoheisist per me shume punemarresa/se. Behet fjale per situatat ne vijim: a) gjate fundjaves; b) gjate festave; c) ne periudhe te pushimeve shkollore; d) ne raste te tjera, permbledhur sherbime te vecanta me kohezgjatje jo me shume se tre dite. Punemarresi/ja paguhet thjeshte per ditet e kryerjes efektive te punes, por pa ditur gjithmone me saktesi sa dite do punoje, mund te mos njohe para kohe pagen, gjithashtu punedhenesi nuk eshte gjithmone i detyruar tu garantoje punemarresve nje numer minimal ditesh pune. Ligji 24 dhjetor 2007, n. 247 disponon qe kjo kontrate mund te vihet ne perdorim vetem ne rast se do parashikohet e disiplinohet nga KKKP te nenshkruara nga organizatat sindikaliste te punemarresve dhe te punedhenesve me perfaqesuese ne nivelin kombetar. Ne vecanerit KKKP do percaktojne caqet maksimale te zgjatjes dhe kmpensimin qe punedhenesi do i paguaje punemarresit/ses, ne rast se ai/ajo do vazhdoje te qendroje ne dispozicion, duke pritur te therritet ne pune.

V.R. Para botimit nuk rezulton hyrja e kesaj kontrate ne asnje prej KKKP perkatese.

a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune nen varesi dhe l.e.q. te pare per arsye pune nen varesi:* **E PASIGURT** (nuk ekzistojne norma specifike per kete kontrate).

b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune nen varesi:* **VARET** (punedhenesi do duhet tu garantoje te huajve/ajave, duke llogaritur nje page normale dhe kompensime per te qendruar ne dispozicion, te ardhura vjetore te pakten ne te njejten shume te ndihmes sociale, € 5.142,67, vlere e 2008).

c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjeter, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune nen varesi:* **VARET** (do duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

d. *Mundesi per te marre l.e.q BE per qendruet me periudhe te gjate:* **VARET** (do duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK:* **VARET** (i huaji/e huaja do duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi, kondite qe rrealizohet nese do permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: E PASIGURT* (i huaji/e huaja do duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi me kohezgjatje te pakten dy vjetore, kondite qe rrealizohet nese kjo lloj kontrate do mund te pervijohet nga KKKP me kohezgjatje te pacaktuar, nese i/e huaji/aja do kete nje te ketij tipi dhe nese do permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

2. Kontrata e punes se pjesetuar ose job-sharing

Puna e pjesetuar ose job-sharing eshte nje kontrate pune nen varesi e vecante, me kohezgjatje te caktuar ose te pacaktuar, ne te cilen dy punemarresa/se ndajne te njeitin vend pune. Dy punemarresit/et vendosin oret e punes javore te kryera nga secili/a (te cilat mund ti ndryshojne me marreveshje ne cdo moment) dhe njoftojne punedhenesin, por sebashku duhet ti garantojne punedhenesit kryerjen e plote te punes. Ne rast se njeri/a nga te dy/ja heq dore nga puna ose pushohet, kontrata perfundon, pervec rasteve kur – ne marreveshje me punedhenesin – ai/a jo nga te dy/ja punemarresit/et qe ende punon eshte i/e gatshem/me te vazhdoje vetem, duke punuar me kohe te pjesshme ose duke kryer te tere punen.

a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune nen varesi dhe l.e.q. te pare per arsye pune nen varesi: E PASIGURT:* (nuk ekzistojne norma specifike per kete kontrate dhe nuk ka lajme mbi te huaja/a qe kane kerkuar v.e.h. ne baze te kesaj kontrate).

b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune nen varesi: VARET* (te huajit/ajes duhet ti sigurohen te pakten 20 ore pune ne jave, ne menyre qe ti garantojne te ardhura vjetore te pakten ne te njejtjen shume te ndihmes sociale, € 5.142,67, vlera e 2008).

c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjeter, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune nen varesi: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

d. *Mundesi per te marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: VARET* (i huaji/e huaja duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi, kondite qe rrealizohet nese permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: VARET* (i huaji/e huaja duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi me kohezgjatje te pakten dy vjecare, kondite qe rrealizohet nese kontrata eshte me kohezgjatje te pacaktuar dhe nese permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

3. Kontrata e punes ne dhenie

Puna ne dhenie eshte nje kontrate pune e subordinuar e vecante, mes punedhenesit (agjensi pune ose dhenese) dhe punemarresit/es, i cili/e cila caktohet nga agjensia dhenese te punoje tek nje subjekt perfitues (i quajtur perdorues), i cili lidh nje kontrate tregtare me dhenesin. Zakonisht, perdoruesi i kerkon personel dhenesit , pasi ka nevojte perkoheisist per nje numer me te madh punemarresish dhe nuk deshiron te punesoje me teper drejtperdrejt. Kontrata mes punemarresit/es e agjensise dhenese mund te jete me kohe te caktuar ose me kohe te pacaktuar, (qendron ne fuqi edhe pas perfundimit te marreveshjes ndermes agjensise dhenese e perdoruesit, duke pritur qe agjensia te caktoje punemarresin/en tek nje perdorues tjetet. Ne rast kontrate me kohe te pacaktuar, dhenesi i jep punemarresit/es kompensime mujore per te qendruar ne dispozicion gjate kohes qe ai/ajo nuk punojne tek asnje perdorues.

a. *Mundesit per te marre v.e.h. per arsye pune nen varesi dhe l.e.q. te pare per arsye pune nen varesi: E PASIGURT:* (nuk ekzistojne norma specifike per kete kontrate. Ne rast infermieresh profesioniste qe caktohen neper struktura shendetesore publike e private e te cilet e marrin l.e.q. per arsye pune jashte kuotave te percaktuara nga dekretet mbi flukset, dhenesi i punes mund te kerkoje leje per marrjen ne pune vetem pasi te kete nje kopie te kontrates te lidhur me perdoruesin).

b. *Mundesit per te shtyre l.e.q. per arsye pune nen varesi: VARET* (perdoruesi duhet ti garantoje te huajit/ajes duke konsideruar pagen normale dhe kompensimet per qendrimin ne dispozicion, te ardhura vjetore te paktin ne te njejten shume te ndihmes sociale, € 5.142,67, vlere e 2008).

c. *Mundesit per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjetet, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune nen varesi: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

d. *Mundesit per te marre l.e.q. BE per qendruar me periudhe te gjate: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

e. *Mundesit per tu regjistruar ne ShShK: VARET* (i huaji/e huaja duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi, kondite qe rrealizohet nese permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

f. *Mundesit per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: VARET* (i huaji/e huaja duhet te kete nje l.q. per arsye pune nen varesi me kohezgjitje te paktin dy vjecare, kondite qe rrealizohet nese kontrata eshte me kohezgjitje te pacaktuar dhe nese permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

4. Kontratat e mesimit te profesionit

Tre llojet e ndryshme te *mesimit te profesionit* jane kontrata pune te nen varesi te vecanta qe lidhen mes nje punedhenesi dhe nje punemarresi/ese (nxenes), ne ato raste kur ky i/e fundit te kete - sipas tipeve te ndryshme te mesimit te profesionit - mbushur moshen 15 vjecare e deri ne moshen 29 vjec. Mesimi i profesionit eshte nje kontrate i ashtuquajtur me shkaqe te perziera, ku, domethene, objekti i shkembimit mes punedhenesit e nxenesit nuk eshte vetem kryerja e punes for edhe formimi qe punedhenesi detyrohet ti jape nxenesit. Nxenesi, ne fakt, kryen gjate orarit javor nje sasi oresh pune te caktuar e gjithashtu nje sasi te caktuar oresh formimi teorik dhe praktik. Te gjitha keto ore jane te paguara, ndonese punedhenesi mund te zgjedhe ti aplikojte nxenesit nivele pagese baraz me dy nivele me te uleta ne krahasim me detyren efektive qe nxenesi kryen. Aspekti i kontributeve ne ngarkim te punedhenesit eshte me i ulet se ai i nje marrredhenie pune normale dhe mbi kete aspekt ai ka nje kursim te madh mbi kostot. Ne perfundim te periudhes te mesimit te profesionit (qe sipas llojeve mund te kete nje kohezgjatje te ndryshme, megjithate jo me te gjate se 6 vjecare), me perjashtim te rastit kur punedhenesi zgjidh kontraten, kjo lloj kontrate trasformohet ne nje kontrate normale pune te nen varesi me kohe te pacaktuar.

- a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune nen varesi dhe l.e.q. te pare per arsye pune nen varesi: E PASIGURT* (nuk ekzistojne norma specifike per kete kontrate dhe nuk ka lajme mbi te huaj/a qe kane kerkuar v.e.h. ne baze te kesaj kontrate).
- b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune nen varesi: PO.*
- c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjetër, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune nen varesi: PO.*
- d. *Mundesi per te marre l.e.q BE per qendruet me periudhe te gjate: PO.*
- e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: PO.*
- f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shtetërore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: JO* (i huaji/e huaja nxenes/e nuk mund te kete nje l.q per arsye pune nen varesi qe zgjat te pakten dy vjet, pasi periudha e mesimit te profesionit ka kohezgjatje te kufizuar).

5. Kontrata e hyrjes ne pune

Kontrata e *hyrjes* ne pune eshte nje kontrate pune nen varesi e vecante qe synon hyrjen ose hyrjen serish ne tregun e punes per kategori subjektesh te vecanta, mbi baze te nje “projekti” individual per adaptim te kompetencave profesionale te punemarresit/es ne nje kontekst pune te caktuar. Behet fjale per keto kategori personash: a) subjekte me moshe nga 18 deri ne 29 vjec; b) te papunesuar gjate nje periudhe te gjate me moshe 29 deri ne 32 vjec; c) punemarres kaluar moshes 50 vjec qe nuk kane nje vend pune; d) punemarres qe deshirojne te kryejne serish veprimtari pune e qe nuk punojne prej te pakten 2 vjet; e) gra te cfaredolloj moshe banonjese ne zona te territorit italian ku indeksi i punesise femerore eshte me i ulet se ai mashkullor te pakten 20% ose ku indeksi i papunesise femerore kalon 10% ate mashkullor; f) persona te cilave u njihen te meta te renda fizike, mendore ose psiqike. Punedhenesi mund te zgjedhe ti aplikoje punemarresit/es nivele pagese baraz me dy nivele me te uleta ne krahasim me detyren efektive qe ai/ajo kryen. Aspekti i kontributeve ne ngarkim te punedhenesit eshte me i ulet se ai i nje marrredhenie pune normale dhe mbi kete aspekt ai ka nje kursim te madh mbi kostot. Kontrata e hyrjes ne pune nuk mund te kete kohezgjatje me te ulet se 9 muaj e me te gjate 18 muaj, me perjashtim te disa rasteve, deri ne 36 muaj, e nuk eshte e perseriteshme.

a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune nen varesi dhe l.e.q. te pare per arsye pune nen varesi: E PASIGURT* (nuk ekzistojne norma specifike per kete kontrate dhe nuk ka lajme mbi te huaj/a qe kane kerkuar v.e.h. ne baze te kesaj kontrate).

b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune nen varesi: PO.*

c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjeter, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune nen varesi: PO.*

d. *Mundesi per te marre l.e.q BE per qendruet me periudhe te gjate: PO.*

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: PO.*

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shtetore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: JO* (i huaji/e huaja nuk mund te kete nje l.q per arsye pune nen varesi qe zgjat te pakten dy vjet, pasi kontrata e hyrjes ne pune ka kohezgjatje te caktuar).

6. Kontrata per shoqerim ne pjesemarrje me kryerje pune

Kontrata *per shoqerim ne pjesemarrje me kryerje pune* eshte nje kontrate pune e pavarur e parasubordinuar, me kohezgjatje te pacaktuar ose te caktuar. Ne baze te kesaj kontrate nje sipermarres (pala anetaruese) i percakton nje punemarresi/ese (pjesemarres) nje kuote shperblimesh te ndermarrjes ose te ndermarrjeve te tija kundrejt kryerjes se punes se pjesmaresit/es. Pjesemarresi/ja kryen punen e vet ne menyre te nje autonomie te lehte e pa pasur garanci fitimesh: ne rast se nuk ka te ardhura, pjesemarresi/ja nuk mund te marre fitime. Pjesemarresi/ja merr pjese edhe tek humbjet, pervec rastit kur kane rene dakort ndryshe, ne te njejten forme te pjesemarrjes tek te ardhurat. Persa i perket anes praktike, puna e pjesemarresit/es kryhet ne menyre te parasubordinuar. Kjo kontrate parashikon detyrimin per palen anetaruese per te kryer derdhje kontributesh ne dobi te pjesemarresit/ses, gjithsesi ne shume me te ulet sesa kontrata e punes nen varesi.

a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune te pavarur dhe l.e.q. te pare per arsye pune te pavarur: VARET* (pala anetaruese duhet ti garantoje te huajit/es pjesemarres/e te ardhura vjetore jo me te uleta se ato qe lejohne perjashtimin nga shpenzimet sanitare, € 8.263,31^{*}, vlere e 2008).

b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune te pavarur: VARET* (pala anetaruese duhet ti garantoje te huajit/ajes pjesemarres/e te ardhura vjetore te pakten ne te njejten shume te ndihmes sociale, € 5.142,67, vlere e 2008).

c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjeter, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune te pavarur: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken a.^{**}).

d. *Mundesi per te marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: VARET* (i huaji/e huaja pjesemarres/e duhet te kete nje l.q. per arsye pune te pavarur, kondite qe rrealizohet nese permbushet kushti i pershkruar ne piken a.^{*}).

^{*} Vlere e cilesuar nga Ministria e Puneve te Jashtme, per arsye te panjohura, ne € 8.400,00.

^{**} Vlere e cilesuar nga Ministria e Puneve te Brendshme, per arsye te panjohura, ne € 8.500,00.

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane : VARET* (i huaji/e huaja pjesemarres/e duhet te kete nje l.q. per arsye pune te pavarur me kohezgjatje te pakten dy vjecare, kondite qe rrealizohet nese permbushet kushti i pershkruar ne piken a. ^{*}).

* Vlere e cilesuar nga Ministria e Puneve te Jashtme, per arsye te panjohura, ne € 8.400,00.

7. Kontrata e bashkepunimit me projekt te caktuar

Kontrata e bashkepunimit me projekt te caktuar eshte nje kontrate bashkepunimi i koordinuar e i vazhdueshem, lidhur me realizimin e nje projekti te caktuar (ose te nje faze te tij). Behet fjale per nje kontrate pune te pavarur te parasubordinuar me kohezgjatje te caktuar, zgjatja e se ciles (e paracaktuar) eshte ajo e projektit. Palet e kontrates jane porositesi (punedhenesi) dhe i porositori (punemarresi/ja) i/e cili/a merr nje porosi pune qe parashikon koordinimin e kryerjes se punes me organizimin e punes se porositesit, pasi eshte funksionale per realizimin e projektit (ose te nje faze te tij) pergatitur nga porositesi duke parashikuar vazhdueshmeri gjate kohes. I/e porositori/a kryen detyren e vet duke e organizuar punen ne menyre te pavarur, pa u paguar me ore, pa patur nje organizim vetjak e pa qendruar nen detyrim te subordinimit. Kjo lloj kontrate parashikon detyrimi per porositesin per te derdhur kontributet per te porositurin/en, por ne sasi me te vogel se kontrata e punes nen varesi.

a. *Mundesit per te marre v.e.h. per arsye pune te pavarur dhe l.e.q. te pare per arsye pune te pavarur: E PASIGURT* (porositesi duhet ti garantoje te huajit/jes te porositur te ardhura vjetore jo me te uleta se ato qe lejojne perjashtimin nga pjesemarrja tek shpenzimi shendetesor, € 8.263,31^{*} vlera e 2008. Megjithate, pasi kjo kontrate nuk eshte nder ato te dekretit mbi flukset e 2007 qe lejojne kryerjen e punes se pavarur, eshte e mundur qe disa kuestura e ente perfaqesuese diplomatiko-consullare italiane refuzojne te japin lejen provizore per hyrje si dhe v.e.h. te huajve qe deshirojne te hyjne ne Itali per te punuar me kete kontrate).

b. *Mundesit per te shtyre l.e.q. per arsye pune te pavarur: VARET* (porositesi duhet ti garantoje te huajit/es te porositur te ardhura vjetore te paktin ne te njejten shume te ndihmes sociale, € 5.142,67, vlera e 2008).

c. *Mundesit per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjeter, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune te pavarur: VARET* (porositesi duhet ti garantoje te huajit/jes te porositur te ardhura vjetore jo me te uleta se ato qe lejojne perjashtimin nga pjesemarrja tek shpenzimi shendetesor, € 8.263,31^{**} vlera e 2008).

* Vlere e cilesuar nga Ministria e Puneve te Jashtme, per arsye te panjohura, ne € 8.400,00.

** Vlere e cilesuar nga Ministria e Puneve te Brendshme, per arsye te panjohura, ne € 8.500,00.

- d. *Mundesi per te marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate: VARET* (duhet te permbushet kushti i pershkruar ne piken b.).
- e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: E PASIGURT* (i/e huaji/a i/e porositur duhet te kete nje l.q. per arsye pune te pavarur, kusht qe plotesohet nese me pare ka pasur nje v.h. per arsye pune te pavarur).
- f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: JO* (i/e huaji/a i/e porositur nuk mund te kete nje l.q. per arsye pune te pavarur me kohezgjatje te pakten dy vjecare, pasi kjo kontrate ka kohezgjatje te caktuar).

8. Kontrata e bashkepunimit rastesor

Kontrata e *bashkepunimit rastesor* eshte nje kontrate pune e pavarur e tipit rastesor, me kohezgjatje te caktuar. Palat e kontrates jane porositesi (punedhenesi) dhe i/e porosituri/a (punemarres/e), i/e cili/a merr porosine per te kryer nje pune qe nuk parashikon vazhdueshmeri, pasi eshte rezultati i nje nevoje rastesore te porositesit, e cila nuk mund te zgjase me shume se 30 dite gjate nje viti e te parashikojte fitime me te larta se € 5.000,00 ne ate vit. I/e porosituri/a kryen detyren e vet duke e organizuar punen ne menyre te pavarur (pa qene i detyruar per subordinimin), me detyrimin e vetem per te perfunduar brenda kohes se marreveshur me porositesin. Pasi kontrata e bashkepunimit rastesor perfundon porositesi e i/e porosituri/a nuk mund te lidhin nje tjetere te te njejtit tip brenda te njejtit vitit.

a. *Mundesi per te marre v.e.h. per arsye pune te pavarur dhe l.e.q. te pare per arsye pune te pavarur: JO* (ligji parashikon qe per te hyre ne Itali veprimtaria e punes se pavarur nuk mund te jete rastesore).

b. *Mundesi per te shtyre l.e.q. per arsye pune te pavarur: JO* (ligji parashikon qe ne rast se eshte e vetme, veprimtaria e punes se pavarur nuk e lejon qendrimin ne Itali).

c. *Mundesi per te ndryshuar nje l.q. te dhene per shkak tjetere, midis atyre qe ligji lejon, ne l.q. per arsye pune te pavarur: JO* (shiko piken b.).

d. *Mundesi per te marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate: JO* (i/e huaji/a nuk mund te marre vetem me ane te kesaj kontrate nje l.q. per arsye pune te pavarur).

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: JO* (shiko piken d.).

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shteterore, ne kushte te barabarta me qytetet italiane : JO* (shiko piken d.).

9. Kontrata e shërbimeve të punës ndihmëse ose kupone pune

Sherbimet e punës ndihmëse ose kupone pune janë kontrata pune të pavarur rastesore me kohezgjatje të caktuar, të dhëna nga persona që rrezikojnë përjashtimin shoqëror ose që akoma nuk kanë hyrë në tregun e punës, ose që rrezikojnë të dalin prej tij. Palet e kontratës janë përfituesi nga puna (punëdhënësi) dhe ofruesi/ja i punës (punëmarres/i/ja), i/e cili/a duhet të bëjë pjesë tek njëra prej kategorive më poshtë: a) të papunësuar prej më gjatë se një viti; b) shtëpiake, studenta/studente e të pensionuar; c) subjekte me aftësi të kufizuara e ata nëpër komunitete riaftësimi; d) punëmarres/e të huaj/a, që qëndrojnë rregullisht në Itali, gjatë muajve pas humbjes së vendit të punës. Këto shërbime mund të jenë pune shtëpiake të vecanta, duke përfshirë asistencë për fëmijë e të moshuar, për të semurë ose persona me handicap, dhënie mesimi privat, pune të vogla kopshtare dhe pastrim e mirëmbajtje banesash e monumentesh, realizim manifestimesh shoqërore, kulturore, ose bamirësie; në bashkëpunim me entet publikë dhe shoqatat vullnetare për pune urgjencash ose solidariteti. Punëmarresit/et e interesuar/a për të kryer këtë lloj kontrate e shfaqin dispozicionin e tyre pranë shërbimeve për punësim ose agjensive për punë. Në përfundim të punës, përfituesit nga puna u japin ofruesve të punës një ose më shumë kupone pagese me vlerë baraz € 7,50. Duke dorëzuar kuponet e pagesës të marra enteve ose shoqatave dhënëse të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe e Sigurimeve Shoqërore, ofruesi /ja e punës marrë € 5,80 për çdo kupon. Enti ose shoqata dhënëse derdh kontributet e sigurimeve shoqërore dhe për sigurimin kundër aksidentëve në punë me vlerë baraz € 1,50 për çdo kupon, për ofruesin/en e punës.

V.R. Ministria e Punës dhe e Sigurimeve Shoqërore nuk e ka shpallur ende masën zbatuese të kësaj lloje forme pune.

a. *Mundësi për të marrë v.e.h. për arsye pune të pavarur dhe l.e.q. të parë për arsye pune të pavarur: JO* (ligji parashikon që për të hyrë në Itali veprimtaria e punës së pavarur nuk mund të jetë rastesore).

b. *Mundësi për të shtyrë l.e.q. për arsye pune të pavarur: JO* (ligji parashikon që në rast se është e vetme, veprimtaria e punës së pavarur nuk e lejon qëndrimin në Itali).

c. *Mundësi për të ndryshuar një l.q. të dhënë për shkak të jetës, midis atyre që ligji lejon, në l.q. për arsye pune të pavarur: JO* (shiko pikën b.).

d. *Mundesi per te marre l.e.q. BE per qendruet me periudhe te gjate: JO* (i/e huaji/a nuk mund te marre vetem me ane te kesaj kontrate nje l.q. per arsye pune te pavarur).

e. *Mundesi per tu regjistruar ne ShShK: JO* (shiko piken d.).

f. *Mundesi per te marre pjese neper konkurset e shperndarjeve te banesave shtetore, ne kushte te barabarta me qytetaret italiane: JO* (shiko piken d.).